



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

### KRYETARI

Nr. 603/1 Prot.

Shkodër, më 25.09 / 2025

### VENDIM

Nr. 19, Datë 24.09.2025

#### **“MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2025, pasi dëgjoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër **“Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Këshillin e Qarkut Shkodër”**, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 36,37 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit Nr.8, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028” si dhe Udhëzimit Plotësues nr.19, datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **16 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim**,

### VENDOSI;

1. Të miratojë Tavanet Përfundimtare të Shpenzimeve të **Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028**, për Këshillin e Qarkut Shkodër sipas pasqyrës dhe relacionit të bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

